

Mbi dhunën e ushtruar ndaj mjekëve

Etikën dhe shërbimin ndaj të sëmurëve në institucionet publike

*Dr. Din Abazaj
President i Urdhrit të Mjekëve
14 Gusht 2012*

Para pak ditësh, u ushtrua dhunë fizike ndaj një mjeku në spitalin e Kukësit. Raste të tilla kanë ndodhur në Vlorë, Berat dhe të përsëritura në Tiranë e gjetkë në përgjigje të të cilave, Urdhri i Mjekëve dhe mjekët kanë protestuar deri në grevë, në kërkim të mbrojtjes së bluzave të bardha dhe të rivendosjes së dinjitetit të mjekut dhe të profesionit mjekësor.

Megjithatë me keqardhje konstatojmë se, deri tani nuk kemi parë ose dëgjuar të jetë dënuar njeri për krimin e ushtruar ndaj mjekëve apo ndonjë masë tjetër në mbrojtje të tyre.

Nisur nga rasti i fundit dhe në vijim të deklarimeve të tjera të përsëritura, në emër të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve protestoj dhe shpreh indinjatën më të thellë duke kërkuar nga strukturat përkatëse të shtetit ndëshkimin e dhunuesve të mjekut dhe mjekëve dhe marrjen e masave në rivendosjen e dinjitetit të mjekëve dhe profesionistëve të tjerë të shëndetit.

Çështja tjetër për të cilën desha të prononcohem është etika dhe shërbimi ndaj të sëmurëve në institucionet publike, për të cilat është shprehur Ministri i Shëndetësisë në disa takime kohët e fundit.

Jam dakord dhe e mbështes Ministrin duke qenë plotësisht të interesuar dhe në mbështetje të tij si Urdhër i Mjekëve, lidhur me thyerjen e etikës profesionale në marrëdhënie dhe komunikimin e mjekëve me të sëmurët, si dhe kundravajtjet e tyre në institucionet publike duke i sorollatur të sëmurët dhe duke i trafikuar në shërbime të ndryshme dhe klinika private. Të sëmurët që paraqiten në klinikat dhe institucionet publike duhet të mbyllin të gjithë ciklin e problemeve të tyre brenda institucioneve, pa qenë e nevojshme të trafikohen në klinika e shërbime të tjera.

Ministria e Shëndetësisë duhet ta nisin me masat ndëshkuese administrative deri në shkarkimin ndaj drejtuesve të institucioneve publike, të cilët qëndrojnë sehirxhi dhe indiferentë ndaj këtyre fenomeneve.

Urdhri i Mjekëve është i gatshëm dhe do të marrë masa ndëshkimore ndaj rasteve të raportuara dhe të denoncuara për këto probleme deri në heqjen e liqensës.

This document was created with Win2PDF available at <http://www.win2pdf.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.
This page will not be added after purchasing Win2PDF.